



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Nr. 1218. Prot

Datë. 03.03.2020

VENDIM

Nr. 143, datë 03/03/2020

për

"Miratimin e Rregullores Arkitektonike të qytetit të Elbasanit"

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; nenin 13, të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); nenin 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 për "Miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar); vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015, "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 29.12.2016, për "Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan"; Urdhrin nr. 27, datë 10.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për "Ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Elbasan"; Manualin e Procedurave të Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Elbasan, miratuar me vendimin nr. 271, datë 10.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë; me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Territorit, si dhe mbështetur në mbledhjen e Këshillit Teknik, si dhe opinionin e shprehur gjatë dëgjesës publike të zhvilluar në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak më datë 05.02.2020.

VENDOSA:

1. Miratimin e Rregullores Arkitektonike të qytetit të Elbasanit, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



RREGULLORJA ARKITEKTONEKE E QYTETIT TË ELBASANIT²



**RREGULLORJA
ARKITEKTONEKE
e qytetit të Elbasanit**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Parimet e rregullores	5
2. Qëllimi.....	5
3. Leja.....	6
3.1 Në rastin e objekteve ekzistuese	6
3.2 Në rastin e objekteve të reja të cilat aplikojnë për leje ndërtimi	6
4. Palët e përfshira në realizim	7
5. Kohëzgjatja.....	7
6. Mirëmbajtja	8
7. Elementet hijëzues në objektet ekzistuese	8
8. Roli i Autorit të objektit.....	8
9. Përkufizime.....	9
10. Evidentimi i ndarjes në lartësi të fasadës	10
10.1 Kati përdhe	10
10.1.1 Hijëzimi i fasadave në katin përdhe	11
10.1.2 Siguria	12
10.1.3 Reklama.....	13
10.1.4 Pergolata në hapësira publike	14
10.2 Ndriçimi	16
10.3 Fasada e mesme.....	16
10.3.1 Vendosja e tendave dhe pergolatave në fasadë.....	17
10.3.2 Grilat	17
10.3.3 Njësia e kondicionimit	18
10.3.4 Antenat apo çdo lloj elementi sinjalimarrës	18
10.4 Fasada e sipërme.....	18
10.5 Pergolatat	19
10.5.1 Pergolat në banesa kolektive.....	19
10.5.2 Hijëzimi me tendë në fasadën e sipërme.....	19
11. Banesat individuale	20
11.1 Hijëzimi i ballkoneve, llozhave në banesat individuale	20
11.1.1 Hijëzimi me tendë në banesat individuale.....	20
11.1.2 Pergolat në banesat individuale me oborr	20
12. Gjelbërimi (tarraca dhe mure të gjelbëruar)	21

13. Rrethime të hapësirave të pronave private	22
13.1 Tipet e rrethimit dhe rregullat për vendosjen e tyre	22
13.1.1 Tipet e rrethimeve për të cilat kërkohet aplikimi për deklarim paraprak:	23
13.1.2 Tipet e rrethimeve për të cilat kërkohet pajisja me leje:	24
13.2.1 Lartësitë e sugjeruara për rrethimet.....	26
13.2.3 Forma, materialet dhe ngjyrat.....	27
13.2.4 Detyrimet dhe sanksionet	27
13.2.5 Sigurimi.....	28
13.2.6 Procedura për lëshimin e lejes	28
13.2.7 Ndalimet.....	28
Mbaj përgjegjësi për çdo lloj tejkalimi të punimeve që përfshin neni 6, "Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi", apo dëmi që i shkaktohet palëve të treta.	45

Bashkëlidhur:

Për objektet ekzistuese

Material grafik i aplikimit për leje vendosje tende dhe pergolate

. Material grafik i aplikimit për leje vendosje pergolate

Material grafik i aplikimit për leje vendosje kondicionimi

Material grafik i aplikimit për leje reklame

Për objektet e reja të cilat futen për leje

Materiali grafik si shembull për paraqitjen e fletës së aksesorëve

1. Parimet e rregullores

Rregullorja Arkitektonike e Qytetit mbulon të gjitha ndërhyrjet në territorin e administruar nga Bashkia Elbasan. Ajo ka për objekt të rregullojë nga ana arkitektonike të gjithë elementët kryesorë që kanë të bëjnë me ndërtimet e reja, shtesat, ndërhyrjet për "Deklaratë paraprake", etj. dhe të ketë një ndërtim **të orientuar drejt standardeve europiane dhe estetike të qytetit**.

Kjo rregullore, duhet tëkoordinohet nga Drejtoria përgjegjëse e planifikimit të territoritë Bashkisë Elbasan me rregulloret e veçanta të Planeve të Detajuara Vendore.

Duke u bazuar në VKM nr.408, datë 13.05.2015, për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar, sipas nenit 7, ku kërkohet Rregullorja Arkitektonike e Qytetit, propozojmë miratimin e Rregullores Arkitektonike të Qytetit të Elbasanit.

Forma dhe përbajtja e kësaj rregullore janë hartuar duke patur disa koncepte bazë të mënyrës sesi veprohet në raste të tilla dhe të problematikave kryesore për të cilat jemi vënë në dijeni. Në varësi të propozimeve që do të vijnë dhe të dokumentacionit që do të shtohet, Rregullorja do të pasurohet nëpërmjet shtojcave dhe anekseve.

2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është:

- 2.1 Të koordinojë ndërhyrjet individuale në fasadat e objekteve dhe rrugëve sipas një koncepti të përgjithshëm arkitektonik të elementeve përkatës hapësinor.
 - i. Të zhvillojë një referencë të unifikuar dhe të aplikueshme për të drejtuar reformat urbane në fasadat e qytetit.
 - ii. Për të çuar më tej objektivat e komunitetit, për të promovuar përdorimin e standardeve të projektimit e të cilësisë.
 - iii. Për të ndihmuar në shpjegimin dhe rregullimin e cilësisë vizuale.
 - iv. Të sigurojë transparencën ndërmjet organit të pushtetit vendor (Bashkisë) dhe komunitetit në drejtim të mbrojtjes së vlerave që ajo përfaqëson, duke mundësuar lëshimin e autorizimeve për ndërhyrje vetëm në përputhje me këtë rregullore.

3. Leja

3.1 Në rastin e objekteve ekzistuese

- Çdo individ që kërkon të kryejë punime në fasadën e ndërtesës, duhet të pajiset me leje nga Bashkia, ose me deklarim paraprak, bazuar kjo sipas llojit të ndërhyrjes që kërkon të realizojë.
- Propozimi duhet të shoqërohet me fletët përkatëse:
 - i. Në shkallën 1:20, në të cilën do të paraqitet projekt i propozuar në të gjitha detajet arkitektonike që lejon kjo shkallë vizatimi;
 - ii. Në shkallën 1:100, në të cilën do të paraqitet projekt i propozuar në përbajtjen e përgjithshme të objektit.
- Çdo propozim do të bëhet në koordinim të plotë me Drejtorinë përgjegjëse të planifikimit të territorit.
- Kërkesa për ndërhyrje do të shoqërohet me takime me specialistët e drejtorisë për të parë nga afér specifikat e secilit rast dhe për të përkufizuar natyrën e ndërhyrjes.
- Fletët e projektit duhet të jenë të punuara, të firmosura e vulosura elektronikisht nga persona të licencuar në këtë fushë dhe t'u përshtaten rigorozisht parametrave të vendosura në rregullore.
- Fotot ose fotomontazhet (në rastin e objekteve të reja) do të jenë të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruara të gjithë elementët aksesorë të fasadës për të cilët kërkohet leja/deklarata paraprake.
- Ndërhyrjet e qënësishme në fasadë, apo që prekin konstruksionet mbajtëse të këtyre objekteve duhet të aprovohen vetëm për rastet kur këto ndërhyrje konsiderohen të domosdoshme për rritje të rritjes së aftësisë struktutore të objektit dhe të kenë deklarimin e ndërhyrjeve nga së paku 3 projektues konstruktorë, si dhe autori projektues.

3.2 Në rastin e objekteve të reja të cilat aplikojnë për leje ndërtimi

Për objektet e reja, lejet e ndërtimit, të të cilave do të miratohen që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Drejtoria përgjegjëse e planifikimit të territorit të Bashkisë Elbasan, që:

- i. Të kërkojë nga Subjektet që aplikojnë për leje ndërtimi, të paraqesin, si pjesë e projektit për miratimin në fasadë, planimetri, fotomontazh dhe relacion, listën e mëposhtme, referuar në këtë rregullore si elemente aksesorë të fasadës.
 - Projektin arkitektonik të vendosjes së tendave hijëzuesve/grilave hijëzuese/pergolatave/kondicionerëve/elementeve gjelbërues.
 - Projektin e vendosjes së tabelave të biznesit përgjatë fasadës së katit përdhe, shoqëruar edhe sipas kateve te tjera me funksion shërbime.

- Projekti duhet të shoqërohet edhe me fletën e aksesorëve, si vendosja e tendave në katin përdhe nëse ka, tendat hijëzuese të ballkoneve nëse do të ketë, pergolatave, etj.
- ii. Përveç rasteve të bizneseve madhore (VIP), si hotele, shkolla, klinika, etj., ku tabelat mund të vendosen vertikalisht, pingul me fasadën, të gjitha tabelat e tjera duhet të vendosen paralele me faqen e fasadës, në varësi të paraqitjes arkitekturore të objektit.
- iii. Në këto projekte, Subjekti Zhvillues dhe Arkitekti i Subjektit, kërkohet që të paraqesin llojet e elementeve aksorë në:
 - Madhësi,
 - Lloj,
 - Model,
 - Kompozim arkitektonik në të gjithë fasadën, për të gjitha fasadat e objektit.
- iv. Të kërkojë planin e gjelbërimit të mureve kallkan të objektit/objekteve, që do të mbulojnë tërësisht, ose pjesërisht muret kallkan të objektit/objekteve, pra ndërtimin e objektit në vazhdim të murit kallkan.
Gjatë hartimit të kësaj pjese të projektit arkitektonik, subjekti duhet të konsultohet me specialistët e Drejtorisë përgjegjëse të planifikimit të territorit dhe Planin e Përgjithshëm Vendor në lidhje me propozimin. Konsultimi do të ketë të bëjë me përbajtjen urbane të ndërhyrjes dhe çfarë duhet të merret parasysh, si p.sh. është ndërhyrja në rrugë parësore/dytësore/tretësore, në nyje të rëndësishme urbane, apo hapësira publike.

4. Palët e përfshira në realizim

Palët, të cilat do të përfshihen në realizimin e këtyre projekteve, janë:

- i. Klienti (pronar, disa bashkëpronarë);
- ii. Arkitekti i ndërhyrjes, inxhinierët;
- iii. Arkitekti i objektit, inxhinierët;
- iv. Bashkia;
- v. Administratori i objektit;
- vi. Komuniteti;
- vii. Komponentët promovues të produkteve të ndryshme.

5. Kohëzgjatja

Duke u mbështetur në llojin e ndërhyrjes, kohëzgjatja për të përfunduar punimet NUK DUHET të kalojë atë të përcaktuar nga leja, apo deklarimi paraprak.

6. Mirëmbajtja

Subjekti apo individi, ka për detyrë të mirëmbajë elementet arkitektonikë të fasadës, të cilat duhet të jenë gjithnjë në gjendje të mirë, të pastra dhe funksionale.

7. Elementet hijëzues në objektet ekzistuese

- i. Subjektet inkurajohen që të vendosin elemente tenda, kapriata, mbulesa tekstili (awning), duke shmangur vendosjen e elementeve vertikalë, si kolonat e çfarëdo lloji/tipi.
- ii. Në rastin kur, vendosja e kolonave është për tenda pergolata, atëherë projekt duhet të jetë i firmosur nga arkitekti autor i projektit arkitektonik të objektit ku propozohet ndërhyrja.
 - Në mungesë të autorit arkitekt, Subjekti duhet të bashkëpunojë me një specialist të Drejtorisëpërgjegjëse të planifikimit të territorit, e përsa më sipër.
 - Duke qenë se, propozimi bëhet për objekte të cilat mund të jenë bërë ndërhyrje të ngjashme si tenda/pergolata, etj., propozimi në vetvete dhe për të gjithë objektin duhet të marrë parasysh përqindjen e objektit, e cila është e mbuluar me elementet aksesorë.
 - Në ndërtesat ekzistuese, ku 30% e hijëzimit dhe ndërhyrjeve është kryer individualisht nga secili banor, procesi, nëse është e kërkuar, duhet të vazhdojë të realizohet në mënyrë që të krijohet një lidhje dhe të unifikohen fasadat.
 - Ngjyrat e përdorura duhet të jenë të unifikuara në të gjithë ndërtesën, me përjashtim të rasteve kur fasada ekzistuese ka trajtim të kombinuar me ngjyra ose veshje të ndryshme, që mund të ofrojë unifikim sipas teksturës në fasadën e objektit.
 - Nëse ndërhyrjet janë më pak se në masën 30%, atëherë koncepti propozues mund të vijë për të gjithë fasadën.
 - Nëse është më shumë se 30%, koncepti duhet të marrë parasysh ndërhyrjet ekzistuese.
 - Merret e mirëqenë që, çdo propozim që ka të bëjë me të gjithë objektin, si për katin përdhe, si për katet mbitokë, projekt do të konsultohet me shumicën e kërkuar nga ligji nr. 10112, datë 09.04.2009, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", i ndryshuar.

8. Roli i Autorit të objektit

Në rastet e objekteve ekzistuese, ku 30% e ndërtesës i ka montuar individualisht:

- Duke u gjykuar sipas rastit dhe duke u konsultuar me specialistin përkatës, vendosjet e reja do të bëhen në mënyrë të tillë që të mos ndërhyjnë në fasadë.
- Në rastet, kur nuk është e mundur një vendosje e tillë, ndërhyrjet në fasadat e objektit/objekteve duhet të marrin në konsideratë edhe mendimin/opinionin, ose të hartohen me lejen e arkitektit autor të projektit.

Ndërhyrjet në fasadat e objekteve duhet të marrin parasysh edhe mendimin/opinionin, ose të hartohen me lejen e arkitektit autor të projektit (në rastet e objekteve të reja).

Arkitekti autor i ndërhyrjes mund të bashkëpunojë me arkitektin autor të objektit, në koordinim me bashkinë, për të përkufizuar një ndërhyrje, e cila ka një vizion të qartë dhe është e përsëritëshme për pjesën tjetër të objektit.

p.sh. Mund të përcaktohet një lloj tende/ose një motiv tende/ose një kombinim tendash për të gjithë objektin.

Strukturat hijëzuese NUK DUHET TË DOMINOJNË vizualisht dhe estetikisht, duke krijuar imazhin e një lloj objekti kioske, etj.

9. Përkufizime

Fasadë: Të gjithë muret e jashtëm të ndërtimit të dukshëm nga rruga, që nuk janë vendosur përgjatë një anë, apo pjesës së pasme të pronës do të njihet si fasadë.

Tendat për hijëzim: Materiale sintetike apo pëlhura tekstili të vendosura në pjesën e jashtme të njësisë, pa pikëmbështetje në truall, që shërbejnë për mbrojtjen nga kushtet atmosferike.

Pergolatat: Është një strukturë statike dhe mund të ketë forma të ndryshme. Mund të lidhet me objektin, ose mund të qendrojë e vetme.

Grilat: Element i fiksuar brenda ose jashtë, një dritareje që mund të jenë të mbyllura për siguri apo privatësi dhe për të mos lejuar dritën.

Reklama: Pajisje publicitare, me rëndësi marketimi.

Elementet e sigurisë: Grilat ose qepenat që mund të jenë material druri, metalik apo plastikë.

Kondicionerë: Pajisje motorrike që bën të mundur ngrohje apo ftohje të ambienteve të banesës, subjektit privat apo publik.

Antena: Element sinjalmarres prej metali në formë dhe përmasa të ndryshme.

Vegjetacion: Bimë kacavjerrëse, ose jo, të përdorura për hijëzim të ndërtesës.


Hapësira publike: Hapësira publike është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjetë që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimave të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit". Në hapësirat publike lejohen të kryhen vetëm aktivitete që janë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre.

10. Evidentimi i ndarjes në lartësi të fasadës

Fasadat e qytetit sjellin vlera arkitektonike të veçanta për qytetin

Standardet e evidentimit të lartësisë së fasadës dhe udhëzimet, kanë qëllim të sigurojnë që fasadat janë të ndara në:

- Bazë (kati përdhe)
- Katet e mesme
- Katet e sipërme.



Me këtë ndarje krijojmë një "shkallë njerëzore" tërheqëse dhe të rehatshme për ndërtesat.

- Baza (kati përdhe) i gjithë kati ose dy katet e para të ndërtesës dhe që artikulohen në mënyrë të dukshme për të ankoruar ndërtesën në tokë.
- Zakonisht të përshtatura ose të projektuara për ambiente tregëtare, shërbimi.
- Katet e sipërme artikulojnë mbylljen e ndërtesës.
- Katet e mesme janë pjesa e mbetur e fasadës (që ndodhet midis bazës dhe katit të sipërm).

10.1 Kati përdhe

Fasadat e kateve të para të strukturave të cilat i nënshtrohen ristrukturimit/rikualifikimit dhe ndryshimit të funksionit, të cilat janë transformuar nga përdorimi banim në përdorime njësi dhe/ose shërbime të tjera në funksion të zonës së banimit, duhet të unifikohen nëpërmjet:

- Përdorimit të materialeve të njëjtë për trajtimin dhe/ose veshjen e fasadës.
- Vendosjen e kontrolluar ose heqjen e tendave dhe hijëzuesve të tjerë të çfarëdo lloji, të paparashikuar në projektin e miratuar të strukturës;

- Vendosjen e kontrolluar të tabelave të reklamave, referuar nenit 12 në vijim;
- Pjesa e fasadës që përballet dhe siguron qasjen për përdorime të veçanta të nivelit shërbime (tregëtar);
- Pjesa ballore e fasadës, ku dhe është aksesi për hyrjen në ndërtesë apo shërbime;
- Në distancën minimale 90 cm, duhet të ketë një pamje pa pengesa të mallrave e shërbimeve të ekspozuar;
- Fasada e katit përdhe ndryshon nga pjesa tjetër, pasi ka karakterin e saj arkitektonik për të shprehur edhe diferencën funksionale me katet e sipërme;
- Ngjyra dhe materialet e bëjnë të dallueshme nga pjesa tjetër e ndërtesës;
- Tendat në katin përdhe duhet të jenë të montuara në faqen e ndërtesës dhe nuk lejohen të kenë element vertikal mbajtës (si është e përshkruar në paragrafët më sipër);
- Tabelë reklame, e cila mund të jetë 60 cm e lartë dhe e vendosur mbi vetratat, por pa kaluar lartësinë e katit;
- Materialet e përdorura duhet të jenë me cilësi të lartë, duke u shprehur në kategorinë e materialit veshës dhe vlerësimin e jetëgjatësisë në mirëmbajtje (pastrimi, ekspozimi ndaj agjentëve atmosferikë);
- Gjithmonë të përdoret xham i qartë dhe i pastër (përjashtim bëjnë vetëm ndërtesat që kanë një element të njehsuar me arkitekturën e fasadave në katet e sipërme që mund të kërkojë një vetratë me xhamia pjesërisht të qartë dhe pa relief në sipërfaqe);
- Tendat e përdorura për hijëzim nuk duhet të dalin më tepër se 90 cm nga fasada e ndërtesës (përjashtohen këtu rastet e bareve, restoranteve, fast-food, etj, për të cilat janë vendosur parametrat në rregulloren për zënien e hapësirave publike);
- Tendat duhet të jenë të lidhura me objektin;
- Tendat e përdorura në një ndërtesë duhet të jenë të njëtrajtësuara (unifikuara).


10.1.1 Hijëzimi i fasadave në katin përdhe

Hijëzimi duhet të jetë i njëtrajtësuar (unifikuar), si për pjesën e katit përdhe, ashtu edhe me pjesën tjetër të ndërtesës.

Llojet e hijëzimit:

- Tenda është një projektim arkitektonik që ofron mbrojtje nga moti, identitet apo dekor dhe është plotësishët e mbështetur në ndërtesën së cilës ajo i është bashkëlidhur.
- Tendat përfshijnë ballinën e ambienteve të shërbimit dhe e bëjnë estetike me një imazh të pëlqyer rrugën për pjesën tregëtare.
- Tendat duhet të kafen e të mbështeten vetëm në ndërtesë.

- Tenda duhet të përdoret në mënyrë që të krijojë hapësira me hije të këndshme para një ndërtese.
- Forma duhet të jetë e dizenjuar me kujdes dhe e përshtatur me pamjen e përgjithshme të ndërtesës.




Fasada me kthinështë një lloj fasade e përdorur për të akomoduar qasje me natyrën dhe për të siguruar akses individual në katin përdhe për bar, restoran apo përdorime të ngjashme. Dhëmbëzimi apo kthina, përfshijnë të gjithë gjerësinë e saj në fasadë, por jo më të madhe se 800 cm (8.00 m) gjerësi dhe 400 cm (4.00 m) thellësi.

10.1.2 Siguria

Në katet përdhe mund të lindi nevoja e shtimit të elementëve në fasadë për të arritur dhe sigurinë e nevojshme.

Duke nisur edhe nga ndarja e kategorive të rrugës, janë vendosur disa standarde për llojet e grilës (qepenit) që do të përdoret duke u nisur nga cilësia dhe paraqitja.



Elementet e sigurimit fizik janë të rëndësishme për çdo biznes. Në zgjidhjen ideale, duhet të jenë në fshehur dhe duhet të jenë me sistem elektronik, POR, nëqoftëse duhet të përdoret një portë, apo duhet të jetë një grilë e hapshme (qepen).

- Nëse do të vendoset që të përdoret grilë (qepen), ajo duhet të jetë e tillë që të lejojë pamjen.
- Kafazi i grilës (qepenit), është një element, i cili duhet të mendohet mirë ku do të montohet, me qëllim që të mos ndërhyjë e të prishë fasadën.

10.1.3 Reklama

Lejohet që subjekti të vendosë pajisje publicitare/reklamuese, vetëm pasi ai të jetë pajisur me autorizimin përkatës të lëshuar nga organet kompetente pranë Bashkisë së Elbasanit, neni 7, i VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

Përveç rasteve të bizneseve madhore, si: hotele, shkolla, klinika, etj. ku tabelat mund të vendosen vertikalisht, perpendindikular/pingul me fasadën, të gjitha tabelat e tjera duhet të vendosen paralele me faqen e fasadës, në varësi të konfigurimit arkitektonik të objektit.

NUK JANË TË LEJUARA:

- a) Projektimi i logove nëmur duhet bërë në më shumë se 30 cm mbi rrugën e këmbësorëve dhe projektimi i çdo logoje tjetër në më pak se 300 cm mbi ngritjen e rrugës.

- b) Logoja të ngjitet pranë daljes së emergjencës/shkallëve të jashtme/dyerve rrëshqitëse/dritareve ose çarjeve nga të cilat vjen ndriçim/ventilimi.
- c) Një projektim i logove të tokës përtej vijës së rrugës.
- d) Logot nëmur që mbulojnë një derë rrëshqitëse/apo dritare pa siguruar më parë një rrugë në rast zjarri.
- e) Logo të ndriçuara në vende të caktuara të kufizuara, e cila sipërfaqja e të gjitha shenjave në katrор nuk duhet të jetë më e madhe se tre herë fasada e rrugës e katit përdhe (katër i parë), apo më shumë se 15 m^2 .
P.sh. Një dyqan me gjerësi fasade 300 cm, mund të ketë një logo (reklamë) jo më të madhe se 3 m^2 .

10.1.4 Pergolata në hapësira publike

Shfrytëzimi i hapësirave publike në Bashkinë Elbasan, është klasifikuar në tri zona sipas gjerësisë rrugore, rëndësisë urbane, dendësisë së qarkullimit, njësive si dhe impaktit që kanë në zhvillimin e qytetit, më konkretisht:

ZONA A

- Bulevardi "Aqif Pasha" (nga sheshi "Elbasan Arena", deri tek sheshi "1 maji");
- Rruga "Qemal Stafa" (nga rrëthrrrotullimi i Postës deri tek kryqëzimi me rrugën "Jashar Ali");
- Rruga "Rinia" (nga kryqëzimi i rrugës "Ismail Zyma", deri tek kryqëzimi me rrugën "Qemal Stafa").

ZONA B

- Rruga "Ismail Zyma", rruga "Shefqet Daiu", kryqëzimi me rrugën "Lef Nosi", kryqëzimi me rrugën "Vasil Kamami" deri në kryqëzimin me rrugën "Koço Brisku" (kufiri verior);
- Kryqëzimi i rrugës "Koço Brisku" me rrugën "Vasil Kamami", rruga "Mahmud Biçaku", vazhduar deri në kryqëzimin me rrugën "11 Nëntori" dhe zgjatimi i kësaj rruge me kryqëzimin e rrugës "Kamber Sejdini" (kufiri lindor);
- Rruga "25 Nëntori" deri tek shkolla e Muzikës, rruga "Ismail Qemali", vijimi me rrugën "Tomorr Sinani", rruga "Ferdinand Paparisto", kryqëzuar me rrugën "Kamber Sejdini", vijim i kësaj rruge deri në daljene rrugës "11 Nëntori" (kufiri jugor);
- Rruga "Janaq Kilica" deri në hyrje të rrugës "Dyli Haxhire" dhe zgjatimi deri në rrëthrrrotullimin e Doganës dhe urën e Zaranikës, rruga "Jashar Ali" deri në daljen e rrugës "25 Nëntori" (kufiri perëndimor).

ZONA C

- Të tjera.

Specifikuar sipas hartës së zonimit për shfrytëzimin e hapësirës publike në bashkinë Elbasan.

Pergolatat mbi hapësira publike duhet të respektojnë sipërfaqjet e miratuara nga Drejtoria përgjegjëse e planifikimit të territoritdhe Bashkia Elbasan.

- Është një strukturë statike dhe mund të ketë forma të ndryshme. Mund të lidhet me objektin ose mund të qendrojë e vetme.
- Dizajni i pergolatës duhet të reflektojë llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Proporcionet duhen gjykuar me kujdes.
- Materialet që përdoren, janë kryesisht: *dru, metal, apo dhe të ndërthuren 2 materiale njëkohësisht*.
- Llojet e pergolatave ndahen duke u bazuar nëtipin eçatisë që kanë (nëse ka). Çatia (mbulesa) mund të jetë me tjegull, polikarbonat ose metalike.
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.
- Në rastetrotuaresh për kategori rrugësh lokale me gjerësi 6.00 m, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 140 cm në rastet kur nuk ka planifikim për sipërfaqe gjelbërimi apo korsi bicikletash, dhe jo më pak se 180 cm kur ka shtylla ndriçimi publik ose gjelbërim, pa korsi bicikletash (sipas sistemit rrugor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbasan).
- Në raste trotuaresh për kategori rrugësh urbane dytësore me korsi makinash 6.00 m, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 150 cm në rastet kur nuk ka planifikim për sipërfaqe gjelbërimi apo korsi bicikletash, dhe jo më pak se 200 cm kur ka shtylla ndriçimi publik ose gjelbërim, pa korsi bicikletash (sipas sistemit rrugor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbasan).
- Për çdo rast trotuaresh për kategori rrugësh urbane kryesore, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 260 cm në rastet kur nuk ka planifikim për korsi bicikletash dhe gjerësia e rrugës është 9.5 m, dhe jo më pak se 300 cm në rastet kur nuk ka planifikim për korsi bicikletash dhe gjerësia e rrugës është 11.5 m (sipas sistemit rrugor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbasan)..
- Mbulimi i pergolatës nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Gjerësia maksimale e pergolatës duhet të jetë deri në kufijtë e vetratës/fasadës së objektit për aktivitet privat, nga do të shfrytëzohet hapësira publike.

Kriteret e vendosjes së pergolata sipas Rregullores Arkitektonike të qytetit të Elbasanit, do të jenë detyruese për të gjitha rastet e aplikimeve për shfrytëzim mbi hapësira publike, që do të vijojnë pas miratimit të kësaj rregullore.

Ndërsa, për pergolatat apo strukturat e tjera të ngjashme ekzistuese deri përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, lind detyra e spostimit të tyre nga vetë personat/subjektet që i zotërojnë, brenda vitit 2020, konform kushteve.

NUK JANË TË LEJUARA:

- a) Zënia e gjerësisë së trotuareve apo gjerësisë së rrugëkalimeve të këmbësorëve apo çiklistëve, që në kryqëzime infrastrukture shoqërohen në vijim me vijëzim kalimi në nivel të korsive të automjeteve.
- b) Shfrytëzimi i ishujve apo hapësirave të gjelbëruara ku rrethimi/konturimi i tyre është i papërshkrueshëm nga rrugëkalime këmbësorësh.
- c) Rrethimi vertikal i hapësirave publike me struktura të paçmontueshme.
- d) Lartësia e pergolatave në hapësirat publike, nuk duhet të cënojë e tejkalojë kuotën e soletës së katit përdhe në pikën kulmore të saj, si p.sh. 4 m.
- e) Të cënohen distancat e ndriçimit publik apo gjelbërimi të qytetit.


10.2 Ndriçimi

I gjithë ndriçimi i jashtëm duhet të bëhet nga një person i licencuar. Shenjat ndriçuese nuk mund të lejohet në disa zona, referuar pozicionit me ndriçimin e qytetit, kodin rrugor dhe zonave të banuara. Duhet të jetë një ndriçim i ngrontë dhe i përgjedhur me kujdes nga personi kompetent.

10.3 Fasada e mesme

Fasada e mesme përbën pjesën më të madhe të ndërtesës/fasadës dhe për këtë arsyе përcakton tonin e përgjithshëm të ndërtesës.

Elementët përbërës të saj janë ballkonet, dritaret.



Për të bërë hijezimin në rastet e ballkoneve, përdoren tenda, të cilat duhet:

- Të mos dalin në më shumë se 50 cm jashtë linjës së fasadës;
- Të mos kenë ngjyra të ndryshme nga njëri ballkon në tjetrin, me përjashtim të rasteve kur vetë ngjyrat, apo materializimi i fasadës është përcaktuar ndryshe;
- Materialet e përdorura duhet të janë me cilësi të lartë dhe jetëgjatësi në mirëmbajtje (pastrimi, eksposimi ndaj agjentëve atmosferikë);
- Të mos janë materiale shumë të ndryshme mes tyre, që dallojnë në të përgjithshmen e fasadës.

Nuk lejohet përdorimi i tendave për hijëzimin e dritareve.

Dritaret do të hijëzimin me grila të llojeve të ndryshme.

Ngjyra dhe lloji do të përcaktohet në projekt duke respektuar kriteret e ngjyrave njësoj si e përgjithshmja e fasadës.

10.3.1 Vendosja e tendave dhe pergolatave në fasadë

Në rastin e fasadës së mesme kemi disa lloje tendash për hijëzimin e ballkoneve. Një nga parimet kryesore për të zhvilluar një shkallë të lartë të estetikës në bazë qyteti.

- Sigurojnë mbrojtje ndaj elementeve nëpërmjet llojeve të ndryshme të tendave të zgjedhura me kujdes e të përshtatura në situatat përkatëse;
- Dizajni i tendave duhet të jetë në favor të stilit, shkallës, formës dhe periudhës së ndërtimit;
- Tendat zakonisht janë me konstrukcion fiks, me kornizë metalike dhe mund të fabrikohen në shumëllojshmëri të gjërë formash;
- Tendat e përdorura duhet të janë të unifikuara në formë, material, dizajn dhe ngjyrë, e cila do të jetë e njëjtë me ngjyrën kryesore të fasadës;
- Materialet në dispozicion të mbulesave të tendës, përfshijnë materiale sintetike, apo pëlhura tekstili, etj. Prodhuesit e tendave duhet të japid informacionin e nevojshëm për të siguruar një kornizë dhe pëlburë, të përshtatshme për kushtet klimatike lokale;
- Tenda nuk duhet të jetë aq e madhe sa të fshehë fasadën e ndërtimit;
- Forma nuk është e përshtatshme të jetë me shumë kulme;
- Pjerrësia e tendës duhet të sigurojë rrjedhjen e ujравe të shiut;
- Nuk pranohet çdo formë, e cila ka një sipërfaqe të sheshtë të konsiderueshme;
- Nuk lejohet përdorimi i tendave për hijëzimin e dritareve;
- Nuk duhet që tenda të errësojë fasadën e ndërtësës, apo detajet arkitektonike;
- Tendat e përdorura për hijëzim nuk duhet të dalin më tepër se 50 cm nga fasada e ndërtësës.

10.3.2 Grilat

Grilat si elemente hijëzuese në rastet e dritareve, por edhe të dyerive të ballkoneve e verandave.

Duke qenë se, dritaret bëjnë pjesën më të madhe të një ndërtëse, atëherë këto marrin pjesë dhe në krijimin e karakterit të këtij objekti.

Hijëzimi i dritareve do të bëhet vetëm nëpërmjet grilave, të cilat ofrohen në lloje ngjyra e materiale të ndryshme, por për një objekt përkatës këto duhet të janë të njëtrajtësuara/unifikuara.

Në një ndërtesë nuk do të lejohet që të përdoren ngjyra dhe lloje të ndryshme grilash, vetëm nëse është parashikuar që në projektimin e objektit dhe e lejuar nga organet përkatëse (nëse kjo bëhet për qëllim të arkitekturës).

10.3.3 Njësia e kondicionimit

Është një aksesor, i cili bën transformim të papëlqyeshëm për fasadën.

Vendosja e kondicionerëve në fasadë nuk është e lejuar, përveçse në rastet kur vendosen në ballkone apo llozha.

Në rastet e objekteve të reja, montimi dhe vendosja e kondicionerit duhet të jetë i parashikuar që në projekt, në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikim në fasadën e ndërtimit.

Në rastet e objekteve ekzistuese, njësia e kondicionimit, nëse nuk ka mundësi të vendoset e fshehur, duhet të vendoset në aks të dritareve dhe të gjithë të jenë në një linjë për secilin kat.

10.3.4 Antenat apo çdo lloj elementi sinjalimarrës

Prezenca e këtyre elementëve në fasadë është tepër shqetësuese për arkitekturën e ndërtesës.


Vendosja e tyre duhet të jetë e siguruar të bëhet në tarracën e ndërtesës sipas legjislacionit sektorial.

10.4 Fasada e sipërme

Fasada e sipërme sigurojnë një "kurorë" për ndërtesën.

Në rastet e tërheqjes së objektit kemi paraqitjen e verandave, hijezimi i të cilave mund të bëhet me:

- Tendë;
- Pergolatë;
- Gjelbërim.



Çdo propozim do të bëhet në koordinim të plotë me Drejtorinë përgjegjëse të planifikimit të territorit.

10.5 Pergolatat

10.5.1 Pergolat në banesa kolektive

- Është një strukturë statike dhe mund të ketë forma të ndryshme. Mund të lidhet me objektin ose mund të qendrojë e vetme.
- Dizajni i pergolatës duhet të reflektojë llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Proporcionet duhen gjykuar me kujdes.
- Materialet që përdoren, janë kryesisht: *dru, metal, ndonjëherë gurë* (kjo duhet shoqëruar edhe me të dhëna teknike të strukturës mbajtëse të objektit me banesa kolektive, për të konfirmuar aftësinë konstruktive me këtë material pergolate), *tulla, si dhe të ndërthuren 2 materiale njëkohësisht*.
- Llojet e pergolatave ndahen duke u bazuar nëtipin e çatisë që kanë (nëse ka). Çatia (mbulesa) mund të jetë me tjegulla, polikarbonat ose metalike.
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.

Verandat në katet e sipërm të banesave kolektive janë një ndër rastet më karakteristike që kërkojnë hijëzim dhe që mund të realizohet me pergolat.

- Në këtë rast pergolata duhet të ruajë një distancë nga parmaku, e cila duhet të jetë më pak se 200 cm në rastet kur veranda ka një gjerësi nga 4 m - 7 m.
- Mbulimi i pergolatës nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Në rastet kur gjerësia e verandës është mbi 5 m, pergolata nuk duhet të ketë zënë më tepër se 50% të sipërfaqes së verandës.

10.5.2 Hijëzimi me tendë në fasadën e sipërme

Në rastet e objekteve të reja, të cilat do të aplikojnë për leje, do të paraqitet materiali grafik për propozimin, ku hijëzimi është menduar me anë të tendës së përzgjedhur. Kjo duhet të jetë e harmonizuar me të gjithë fasadën e ndërtesës.

Specifisht,

- Forma nuk është e përshtatshme të jetë me shumë kulme;
- Pjerrësia e tendës duhet të sigurojë rrjedhjen e ujrave të shiut;
- Nuk pranohet çdo formë, e cila ka një sipërfaqe të sheshtë të konsiderueshmë;
- Nuk lejohet përdorimi i tendave për hijëzimin e dritareve;
- Materialet në dispozicion të mbulesave të tendës përfshijnë materiale sintetike apo pëlhura tekstili, etj.
- Tendat e përdorura duhet të jenë të përdorura në formë, materialet, dizajn dhe ngjyrë, e cila do të jetë e njëjtë me ngjyrën kryesore të fasadës.

11. Banesat individuale


11.1 Hijëzimi i ballkoneve, llozhave në banesat individuale

11.1.1 Hijëzimi me tendë në banesat individuale

- Dizajni i tendave duhet të jetë në favor të stilit, shkallës, formës dhe periudhës së ndërtesës.
- Tenda nuk duhet të jetë aq e madhe sa të fshehë fasadën e ndërtimit.
- Tendat do të përdoren për hijëzimin e llozhave apo ballkoneve.
- Tendat nuk do të përdoren për hijëzimin e dritareve.
- Tendat e përdorura duhet të jenë të njëtrajtësuara/unifikuara në formë, material, dizajn dhe ngjyrë.

11.1.2 Pergolat në banesat individuale me oborr

- Dizajni i pergolatës duhet të reflektojë llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Proporcionet duhen gjykuar me kujdes.
- Lartësia jo më shumë se 2.5 m.
- Në rastet kur struktura është në formë çatie, kulmi mund të arrijë deri në 4 m, nëse nuk cënon dritaret apo çarjet që kryejnë ventilimin e banesës.



- Sa më larg nga kufiri më mirë, kjo largësi të jetë duke filluar nga 3 m.
- Nuk duhet të mbulojë më shumë se gjysmën e sipërfaqes së tokës ku do të realizohet propozimi.
- Nëse janë ose jo të nevojshme, me material jo të djegshëm.
- Mund të jetë e lidhur me ndërtesën, ose e veçuar.
- Çatia (mbulesa) mund të jetë me tjegull, polikarbonat ose metalike.
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.
- Materialet që përdoren janë kryesisht: *dru, metal, ndonjëherë gurë, tulla, si dhe të ndërthuren 2 materiale bashkë*.

Për marrjen e lejes për realizimin e këtyreve strukturave, personi kërkues duhet të paraqesë materialin e nevojshëm:

- Plani i strukturës së propozuar, minimumi në shkallë 1:100;
- Dy pamje dhe prerje në shkallë 1:100;
- Një plan i përgjithshëm dhe i plotë, ku të tregohet vendndodhja e strukturës së bashku me të gjitha matjet e tjera përkatëse dhe detajet (p.sh. Distanca nga kufiri, kullimi, etj. dhe, në shumë raste, të dhënat e pronës kufitare);
- Të gjitha matjet duhet të jenë në njësi metrike dhe shkallët duhet të tregohen në mënyrë të qartë.

12. Gjelbërimi (tarraca dhe mure të gjelbëruar)

Fasadat e gjelbëruar si element hijëzues.

Hijëzimi i fasadave, apo ballkoneve e tarracave mund të bëhet:

- Fasada e gjelbër është krijuar nga rritje të bimëve kacavjerrëse në të gjithë fasadën e një ndërtese, ose nga bimët e rritura në shtretër kopësht në bazën e saj, ose me mbjelljen në enë të instaluara në nivele të ndryshme në të gjithë ndërtesën.
- Fasadat e gjelbra jepin një pamje têrheqëse për njëmur të ndërtesës, duke i dhënë prioritet trajtimit të fasadave në aplikimin për leje.
- Ato mund të përdoren për të siguruar hije për një ndërtesë, fasadat e gjelbra mund të krijojnë një mikroklimë të freskët menjëherë ngjitur më një ndërtesë, para së gjithash përmes mbrojtjes nga drita natyrale e drejtpërdrejtë.

Gjelbërimi mund të aplikohet nëpër tarracat e ndërtesave, të cilat mund të jenë të aksesueshme nga banorët, duke i bërë këto të kthehen në një ambient të këndshëm dhe duke i shtuar vlera objektit dhe qytetit, si trajtim me prioritet tek aplikimi për leje objekti të ri kur propozon tarracë të gjelbër.

Në verandat e krijuara në katet e sipërme, gjithashtu hijëzimi mund të krijohet me anë të gjelbërimit.

Pergolatat e përmendura më sipër, përveç materialeve të përdorura për mbulime të përshkruara, këtë mbulim mund ta realizojnë edhe nëpërmjet gjelbërimit.

13. Rrethime të hapësirave të pronave private

Përshkrimi

Është një strukturë statike e projektuar me shumë pikëmbështetje mbi truall, e cila përdoret si element kufizues për të konturuar dhe dalluar hapësirat private dhe kufijtë e pronës.

Mund të ketë forma e materiale të ndryshme, si dhe të lidhet me objektin, ose të qendrojë e vetme.

Qëllimi

Përcaktimi i kritereve të sakta për mënyrën e realizimit të këtyre strukturave lidhur me subjektet që përfshihen në kategoritë: pronë truall/arë dhe objekte me karakter banimi ose shërbimi. Për të njëjtën objekt rrethimi mund të përdoren edhe elemente kufizimi të ndryshëm.

Leja

Çdo subjekt që kërkon të bëjë një rrethim të hapësirës private në funksion duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Bashkia.

13.1 Tipet e rrethimit dhe rregullat përvendosjen e tyre

Kategoritë

Këto kategori do të ndahen në tre grupime:

- Rrethim të pronës private (truall, arë);
- Rrethim të banesës individuale;
- Rrethim të biznesit (shërbimit);

Duke iu referuar dhe kritereve të përcaktuara sipas Kodit Rrugor.

Përkufizime

Rrethim të pronës private: Një hapësirë e llojit truall apo arë, ku lind nevoja të rrighthet për arsyet e ruajtjes apo vendosjes së kufijve të pronës.

Rrethim të biznesit: Një hapësirë e përdorur në shërbim të aktivitetit privat, si: industrial, ku lindnevoja e rrethimit të hapësirës, ku zhvillohet aktiviteti dhe shfaqin nevojnë e rrethimit përfshirë sigurie.

Rrethim të banesës individuale: Hapësira e përdorur për aktivitete të ndryshme, gjelbërim, argëtim, parkim, etj.

Kjo lloj zënie hapësire nuk mbyll me mjete të tjera, të cilat nuk janë përcaktuar në leje.



13.1.1 Tipet e rrethimeve për të cilat kërkohet aplikimi për deklarim paraprak:

- i. Rrethim me rrjete metalike;
- ii. Rrethim me kangjella druri;
- iii. Rrethim me kangjella metalike;
- iv. I kombinuar (struktura të kombinuara që hiqen në çdo rast pa themele dhe pjesa tjetër kangjell metatike/druri);
- v. Rrethim me xham të temperuar.

Konkretnisht:


- i. Rrethim me rrjete metalike

Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm.




- ii. Rrethim me kangjella druri

Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm.




- iii. Rrethim me kangjella metalike
Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm.



- iv. I kombinuar (struktura të kombinuara që hiqen në çdo rastpa themele dhe pjesa tjetër kangjell metatike/druri)
Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm.

- v. Rrethim me xham të temperuar.
Lartësia maksimale duhet të jetë 160 cm.



13.1.2 Tipet e rrethimeve për të cilat kërkohet pajisja me leje:

- i. Rrethime me muraturë tulle/guri dekorative;


ii. Rrethime me muraturë tulle.

Konkretnisht:

i. Rrethime me muraturë tulle/guri dekorative


Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm, me përjashtim të rasteve kur muret gjatësore në vazhdimësi sipas konturit të peizazhit të rrugës dhe kufirit të pronave në rrugët kryesore apo dytësore, kanë lartësi më të madhe.

Tulla, guri dekorativ për zona apo objekte të trashëgimisë kulturore përcaktohet dhe miratohet nga institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit sektorial për trashëgiminë kulturore dhe dispozitave në zbatim të tij.



ii. Rrethime me muraturë tulle

Lartësia maksimale duhet të jetë 200 cm, me përjashtim të rasteve kur muret gjatësore në vazhdimësi sipas konturit të peizazhit të rrugës dhe kufirit të pronave në rrugët kryesore apo dytësore, kanë lartësi më të madhe.



13.2.1 Lartësitë e sugjeruara për rrithimet

Në varësi të kërkesës apo llojit mund të përdoren lartësi të ndryshme.

Të gjitha llojet e rrithimit duhet të kenë një lartësi maksimale 280 cm.

Lloji i rrithimit dhe lartësia e tij duhet të përshtatet sipas rastit me objektin dhe me vendndodhjen e tij (konkretnisht, do të differencohej nëse do të bëhet kërkesë për rrithim të një banese në afërsi të qendrës së qytetit, zonës arkeologjike, apo në një zonë rurale, sipas kushteve arkitektonike të saktësuara sipas rregullave në fuqi).

Në rastet kur rrithimi do të bëhet në zona urbane, kërkohet që këto të realizohen në mënyrë që të ketë më shumë transparencë, por gjithmonë pa cënuar sigurinë. Duhet të reflektojë llojin dhe karakteristikat e objektit. Struktura duhet të jetë e integruar dhe nuk duhet të ndërhyjë në kurorën e pemëve.

- Parcelat mund të rrithohen me mur deri në lartësinë prej 200 cm nga niveli i terrenit (trotuarit) në aksin e kufirit të parcelave fqinje, apo të rrithohen në anën nga rruga publike me mure në lartësi prej 80 cm, apo me rrithim transparent me lartësi deri në 160 cm.
- Rrithimet e parcelave që kufizohen me kryqëzime nuk mund të jenë më të larta se 80 cm, për shkak të sigurimit të shikimit vizual të kryqëzimit.
- Përjashtimisht nga kriteret e parathëna me këtë pikë, për objektet shtetërore dhe të përfaqësive diplomatike, për të cilat është e domosdoshme siguria e veçantë, rrithimi prej muri, apo ai transparent mund të jetë edhe më i lartë nga ai i parashtuar në këtë pikë. Nuk përjashtohet edhe përdorimi i mureve të gjelbër¹ për rritjen e lartësisë vizuale për efekt shikueshmërie sipas karakterit dhe funksionit të objektit.

¹ Muri i gjelbër i referuar mureve me bimë kacavjerrëse, ose me bimësi në formë shkurre të dendura që mund të krasiten dhe t'u jepen forma të ndryshme estetike gjatë mirëmbajtjes.

- Në rastet kur rrëthimet do të bëhen në zona rurale, parcelat në vendbanimet rurale mund të rrëthohen në anën e rrugës publike me mure në lartësi prej 120 cm, apo me rrëthim transparent për lartësi prej 190 cm. Rrëthimet nga parcelat fqinje mund të vendosen edhe në aksin e kufirit të parcelave fqinje, nëse për këtë jepet pëlqimi nga fqinjët.
- Parcata në vendbanimet rurale mund të ndahet në pjesë funksionale: në pjesën e banimit, ekonomike dhe ndihmëse.
- Për objekte në funksion të agriturizmit, prodhimit dhe përpunimit bujqësor, kriteret e rrëthimit të pronës përcaktohen që gjatë aplikimit për leje ndërtimi, kur janë raste ndërtimi për herë të parë.

13.2.3 Forma, materialet dhe ngjyrat

Këto mund të lihen sipas dëshirës së subjektit (zhvilluesit), përveç rasteve kur ato specifikohen nga Bashkia.

Në qendrat historike, apo arkeologjike, për të ruajtur trashëgiminë, këto elementë i përcakton Bashkia, duke respektuar ligjin sektorial dhe aktet në zbatim të tij, duke i specifikuar në lejen që do të lëshohet për subjektin (zhvilluesin).

Rrëthimi në asnjë rast nuk duhet të dalë jashtë hapësirës së përcaktuar në lejen e lëshuar për këtë qëllim. Rrëthimet nuk duhet të janë në kontrast më karakteristikat arkitektonike të zonës dhe mund të jetë e mbuluar me bimë kacavjerrëse.

13.2.4 Detyrimet dhe sanksionet

Mirëmbajtja dhe ruajtja e karakteristikave të rrëthimeve, duhet të janë objekt i kujdesit të vazhdueshëm. Njëkohësisht, janë të ndaluara tjetërsimet e elementeve të dekorit, në të kundërt do të merren masa ndëshkimore.

Rrëthimet nuk duhet të bllokojnë fushën e shikimit të përcaktuar në dispozitat e përgjithshme.

Ndalohet që rrëthimi të ketë mbyllje nga pjesa ballore dhe anësore përgjatë rrugës kryesore.

Strukturat duhet t'i rezistojnë kushteve atmosferike, për këtë duhet të janë të fiksuar mirë në truall, në mënyrë që të mos përbëjnë asnjë rrezik për kalimtarët.

Llojet e rrëthimeve nuk duhet të mbajnë asnjë lloj reklame dominante në disproporcione me lartësinë dhe elementët dekorativë të rrëthimit.

13.2.5 Sigurimi

- Mbështetjet në truall nuk duhet të pengojnë, ose të rrezikojnë qarkullimin këmbësor dhe duhet të garantojnë një qendrueshmëri të mirë të rrëthimit.
- Në rast se, rrëthimi kryhet me xama, ato duhet të jenë të pathyeshëm (temperuar).

13.2.6 Procedura për lëshimin e lejes

- Çdo subjekt, i cili është i interesuar për të realizuar një rrëthim, duhet të paraqesë në Bashki kërkesën sipas sistemit elektronik në platformën e-leje, për t'u vlerësuar sipas afateve të parashikuara në kuadrin ligjor dhe akteve në zbatim të tij.
- Dokumentet do të paraqiten të plotësuara, siç janë të specifikuara në formularin e kërkesës së lejes për këtë kategori në platformën elektronike, qëi vihet në dispozicion subjektit (zhvilluesit) nga Bashkia.
- Subjektet (zhvilluesit) që do të aplikojnë për leje, duhet të kenë parasysh disa rregulla për plotësimin e dokumentacionit që kanë të bëjnë me planimetrinë dhe fotot e pronës apo objektit, si më poshtë:
 - Fletët teknike duhet të jentë të punuara, të firmosura elektronikisht nga persona të licencuar në këtë fushë dhe t'u përshtaten plotësisht parametrave të vendosura në rregulloren për rrëshimin e hapësirave publike.
 - Fotot do të jenë të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruar veçantë: pamja ballore, pamjet anësore. Në të gjitha fotot duhet të jetë e shënuar data e kryerjes së tyre, si dhe çdo saktësim sipas ligjit të planifikimit të territorit dhe dispozitave në zbatim të tij.

13.2.7 Ndalimet

Nuk lejohet rrëthimi i hapësirës private në rastet kur:

- Ndikon për keq në dekorin e qytetit;
- Nuk përmblidhet normat;
- Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit.

Shtojca A Hapësirat ku mund të vendoset rrëthimet

LLOJET E RRËTHIMIT	RRËTHIMI ME RRJETË						
	METALIKE			DRURI			
RRËTHIM ME KANGJELLA			METALIKE				
a Rrëthim i Pronës Private në zona urbane	<input type="checkbox"/>						
b Rrëthim i Pronës Private në zona rurale	<input checked="" type="checkbox"/>						
c Rrëthim i Banesës Individuale në zona urbane	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
d Rrëthim i Banesës Individuale në zona rurale	<input checked="" type="checkbox"/>						
e Rrëthim i Biznesit	<input checked="" type="checkbox"/>						
f Rrëthim në Zonat Ushtarakë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
g Zona të tjera	<input type="checkbox"/>						

Shënim:

■ Lejohet vendosja e tyre në të gjitha rastet që plotësojnë kushtet e rregullores.

□ Vendosja e tyre është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës.

Nr.
Datë _____

Prot. _____

KËRKESË

LEJE PËR RRETHIM TË HAPËSIRËS PRIVATE

Drejtuar: **BASHKISË SË ELBASANIT**

Unë i/e
 nënshkruari/ja _____, banues/e në tel.
 adresën _____, cel. _____
 identifikimi _____, dhe me dokument
 bazuar në ligjin nr. _____, datë _____,
 " _____",
 Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. _____, datë _____,
 për _____, si dhe rregullores
 "Rrethimi i hapësirës private", në emër të subjektit
 fizik/juridik _____ me seli në
 adresën _____,

Kërkoj:

Pajisjen me leje për rrethimin e hapësirës private:

- | | | |
|--|---------------------------|----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Rrethim i pronës private | Sip. _____ m ² | <input type="checkbox"/> Rinovim |
| <input type="checkbox"/> Rrethim i banesës individuale | Sip. _____ m ² | |
| <input type="checkbox"/> Rrethim i biznesit | Sip. _____ m ² | |

Duke përdorur këtë lloj rrethimi:

- | | |
|---|----------------|
| <input type="checkbox"/> Rrethim me rrjetë metalike | _____ m linear |
| <input type="checkbox"/> Rrethim me kangjella druri | _____ m linear |
| <input type="checkbox"/> Rrethim me kangjella metalike | _____ m linear |
| <input type="checkbox"/> I kombinuar (muraturë + kangjell) | _____ m linear |
| <input type="checkbox"/> Rrethim me xham të temperuar | _____ m linear |
| <input type="checkbox"/> Rrethim me muraturë tulle/guri dekorativ | _____ m linear |

Rrethim me muraturë tulle _____ m linear

Bashkëlidhur dorëzoj dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatë personale me fotografi
2. Genplan i azhornuar nga Bashkia Elbasan, shkalla 1:500 e firmosur nga specialisti. Planimetria, shkalla 1:100 e firmosur nga specialisti.
3. Skicën origjinale të firmosur dhe të vulosur nga një arkitekt/inxhinier i licencuar.
4. Fotografi të gjendjes ekzistuese në rastin kur subjekti i kërkon të rinovojë rrethimin.

DEKLARATË

- Mbaj përgjegjësi civile dhe penale për çdo lloj dëmi që i shkaktohet palëve të treta nga struktura e rrethimit që do të zhvillojë.
- Deklaroj që lloji i rrethimit është konform normave të përcaktuara në rregulloren për rrethimin e hapësirës private.

Kërkuesi _____

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR VENDOSJEN E REKLAMAVE

Reklama:

Lejohet që subjekti të vendosë pajisje reklamuese vetëm pasi ai të jetë pajisur me autorizimin përkatës të lëshuar nga organet kompetente pranë bashkisë Elbasan.

Përveç rasteve të bizneseve madhore, si hotele, shkolla, klinika, etj. ku tabelat mund të vendosen vertikalisht, perpendikular/pingul me fasadën, të gjitha tabelat e tjera duhet të vendosen paralel me faqen e fasadës, në varësi të konfigurimit arkitektonik të objektit.

Nuk janë të lejuara:

- Projektimi i logove nëmuri në më shumë se 30 cm mbi kuotën e rrugës së këmbësorëve dhe projektimi i çdo logoje tjetër me më shumë se 300 cm mbi ngritjen e rrugës.
 - Logoja të njijitet pranë daljes së emergjencës/shkallëve të jashtme/dyerve rrëshqitëse/dritareve ose çarjeve nga të cilat vjen ndriçimi/ventilimi.
 - Pojektimi i logove të tokës përtej vijës së rrugës.
 - Logot nëmuri që mbulojnë një derë rrëshqitëse, apo dritare, pa siguruar më parë një rrugë evakuimi në rast zjarri.
 - Logo të ndriçuara në vende të caktuara, të kufizuara, sipërfaqja e të gjitha shenjave në katror nuk duhet të jeta më i madh se 3 (tre) herë fasada e rrugës e katit të parë (kati përdhe), apo më shumë se 15 m².
- P.sh. një dyqan 300 cm i gjerë mund të ketë një logo (reklamë) jo më të madhe se 3 m².*

Ndriçimi:

I gjithë ndriçimi i jashtëm duhet të bëhet nga një person i licencuar.

Shenjat ndriçuese nuk mund të lejohen në disa zona².

² Referuar zonës së trashëgimisë historike, zonave më impakt direkt në banesa private, apo në mjestise me rëndësi të veçantë sipas kushteve dhe kriterieve të tyre sektoriale.


RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR VENDOSJEN E PERGOLATAVE

- Është një strukturë statike dhe mund të ketë forma të ndryshme. Mund të lidhet me objektin, ose mund të qendrojë e vetme.
- Dizajni i pergolatës duhet të përputhet me llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Proporcionet duhen gjykuar me kujdes.
- Materialet që përdoren, janë kryesisht: dru, metal, ndonjëherë gurë (kjo duhet shoqëruar edhe me të dhëna teknike të strukturës mbajtëse të objektit me banesa kolektive, për të konfirmuar aftësinë konstruktive me këtë material pergolate), tulla, si dhe ndërthurje e dy materialeve njëkohësisht.
- Llojet e pergolatave ndahen, duke u bazuar në çfarë çatje kanë (nëse kanë). Çatia (mbulesa) mund të jetë me tjegull, polikarbonat ose metalike.
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.
- Pergolatat që zënë hapësira në kate përdhe, apo pozicionohen në sheshe dhe hapësira publike, paraprakisht duhet të kenë marrë:
 - konfirmimin përsipërfaqen e lejuartë shfrytëzimit të hapësirës publike nga Drejtoria përgjegjëse e planifikimit të territorit Bashkisë Elbasan me rregulloren arkitektonike të qytetit, si dhe dakordësimin për dekorin e rrugëve apo zonave me impakt në estetikën e qytetit,
 - miratimin e shlyerjes së detyrimeve për tatim taksat për sipërfaqen e hapësirës publike në fjalë pranë bashkisë,
 - si dhe miratimin në sistemin e-leje, sipas dispozitave ligjore.


Specifikuar sipas hartës së zonimit për shfrytëzimin e hapësirës publike në bashkinë Elbasan, vlerë të veçantë ka qendra e qytetit dhe rrugët kryesore të tij, Zona A dhe Zona B, apo çdo vendimmarrje sipas prioriteteve të Bashkisë.

- Në raste trotuaresh për kategori rrugësh lokale me gjerësi 6.00 m, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 140 cm në rastet kur nuk ka planifikim për sipërfaqe gjelbërimi apo korsi bicikletash, dhe jo më pak se 180 cm kur ka shtylla ndriçimi publik ose gjelbërim, pa korsi bicikletash.
- Në raste trotuaresh për kategori rrugësh urbane dytësore me korsi makinash 6.00 m, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 150 cm në rastet kur nuk ka planifikim për sipërfaqe gjelbërimi apo korsi bicikletash, dhe jo më pak se 200 cm kur ka shtylla ndriçimi publik ose gjelbërim, pa korsi bicikletash (si p.sh. rruga "Rinia").


Rruja Rinia



- Për çdo rast trotuaresh për kategori rrugësh urbane kryesore, pergolata duhet të ruajë një distancë të lirë nga bordura e trotuarit, e cila duhet të jetë jo më pak se 260 cm në rastet kur nuk ka planifikim për korsi bicikletash dhe gjerësia e rrugës është 9.5 m, dhe jo më pak se 300 cm në rastet kur nuk ka planifikim për korsi bicikletash dhe gjerësia e rrugës është 11.5 m (si p.sh. Bulevardi "Aqif Pasha" apo rruga "Qemal Stafa").



Bulevardi



- Mbulimi i pergolatës nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Gjerësia maksimale e pergolatës duhet të jetë deri në kufijtë e vetratës/fasadës së objektit për aktivitet privat, nga do të shfrytëzohet hapësira publike.


Kriteret e vendosjes së pergolata sipas Rregullores Arkitektonike të qytetit të Elbasanit, do të jenë detyruese për të gjitha rastet e aplikimeve për shfrytëzim mbi hapësira publike, që do të vijojnë pas miratimit të kësaj rregullore.

Ndërsa, për pergolatat apo strukturat e tjera të ngjashme ekzistuese deri përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, lind detyra e spostimit të tyre nga vetë personat/subjektet që i zotërojnë, brenda vitit 2020, konform kushteve.


Verandat në katet e sipërm të banesave kolektive janë një ndër rastet më karakteristike që kërkojnë hijëzim dhe që mund të realizohet me pergolatë.

- Në këtë rast, pergolata duhet të ruajë një distancë nga parmaku, e cila nuk duhet të jetë më pak se 200 cm në rastet kur veranda ka një gjerësi nga 4 m - 7 m.
- Mbulimi i perglatës nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Në rastet kur, gjerësia e verandës është mbi 5 m, pergolata nuk duhet të zërë më tepër se 50% të sipërfaqes së verandës.


HARTA E ZONIMIT PER SHRYTEZIMIN E HAPSIRES PUBLIKE NE BASHKINE ELBASAN. SH.1:3000




Bulevardi "AQIF PASHA"



Ruga "QEMAL STAFA"



Ruga "RINIA"



Nr.
Datë _____

Prot.

KËRKESË**LEJE PËR SHFRYTËZIM TË HAPËSIRËS PUBLIKE**

Drejtuar:

BASHKISË SË ELBASANIT

Unë _____ i/e
 nënshkruari/ja _____, banues/e në
 adresën _____ tel.
 _____, cel. _____ dhe me dokument
 identifikimi _____,

bazuar nëligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen vendore",
 ligjinnr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i
 ndryshuar), VKM nr.1096, datë 28.12.2015, "Për miratimin e rregullave, kushteve e
 procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; Vendimin e
 Këshillit Bashkiak nr.179, datë 04.11.2019, "Mbi taksat dhe tarifat vendore në
 Bashkinë Elbasan për vitin 2020", si dhe "Rregullores arkitektonike të qytetit të
 Elbasanit", në emër të subjektit
 fizik/juridik _____ me seli
 në adresën _____,

Kërkoj:

Pajisjen me leje për shfrytëzim të hapësirës publike:

- Hapësirë e pronës publike Sip. _____ m²
 Rinovim Sip. _____ m²

Në funksion tëkëtij shërbimi:

- | | |
|---|----------------------|
| <input type="checkbox"/> Bar, restorant | _____ m ² |
| <input type="checkbox"/> Prodhim ushqimor | _____ m ² |
| <input type="checkbox"/> Tregëtim ushqimor | _____ m ² |
| <input type="checkbox"/> Tregëtim mallrash | _____ m ² |
| <input type="checkbox"/> Lojra | _____ m ² |
| <input type="checkbox"/> Të tjera _____ (specifiko) | _____ m ² |

Bashkëlidhur dorëzoj dokumentet e mëposhtme:

5. Kartë identiteti (pronari/marrësi në përdorim/personi me prokurë).
6. Orthofoto të pozicionimit të pronës private dhe zonës ku kërkon shfrytëzimi i hapësirës publike.
7. Kopje të Certifikatës së pronësisë, kontratën e qerasë për pronësinë private.
8. Planimetri të pronësisë private (që është në përdorim për shërbim aktiviteti privat).
9. Fotografi të gjendjes ekzistuese në rastin kur subjekti i kërkon të rinojë shfrytëzimin e hapësirës publike.
10. Kopje të kontratës për shfrytëzim të hapësirës publike kur subjekti i kërkon të rinojë kontratën e shfrytëzimit.

DEKLARATË

- Mbaj përgjegjësi civile dhe penale për çdo lloj dëmi që i shkaktohet palëve të treta nga shfrytëzimi i hapësirës publike.
- Deklaroj që lloji i shfrytëzimit është konform normave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Kërkuesi _____ (emër, mbiemër, firmë)

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR VENDOSJEN E TENDAVE NË OBJEKTET EKZISTUES

1. Tenda është një element arkitektonik që duhet të ofrojë mbrojtje nga kushtet e motit, identitet apo dekor dhe është plotësisht e mbështetur në ndërtesën e së cilës ajo i bashkëngjitet.
2. Dizajni i tendave duhet të jetë në favor të stilit, shkallës, formës dhe periudhës së ndërtesës dhe ndalohen kategorikisht instalimet që shkaktojnë tjetësim të fasadës.
3. Tendat e përdorura duhet të janë të unifikuara në formë, material, dizajn dhe ngjyrë, e cila do të jetë e njëjtë me ngjyrën kryesore të fasadës, apo një ngjyre të përcaktuar sipas dekorit të zgjedhur që në projekt.
4. Konstruksioni i përdorur duhet të jetë fiks dhe t'i rezistojë erërave, me kornizë metalike ose druri.
5. Materialet në dispozicion të mbulesave të tendës përfshijnë materiale sintetike apo pëlhura tekstili, etj.
6. Tenda nuk duhet të jetë aq e madhe sa të fshehë, apo të mbulojë elementë të rëndësishëm arkitektonik të fasadës së objektit.
7. Pjerrësia e tendës duhet të sigurojë rrjedhjen e ujrave të shiut.
8. Nuk lejohet përdorimi i tendave për hijëzim të dritareve.
9. Tendat e propozuara për katet banim, nuk duhet të dalin më tepër se 50 cm nga linja e fasadës së ndërtesës.
10. Për katet përdhe, me funksion tregëtar, tendat e propozuara nuk duhet të dalin më tepër se 90 cm nga fasada e ndërtesës.
11. Për katet përdhe duhet të janë të montuara në faqen e ndërtesës dhe nuk lejohen të kenë elementë vertikalë mbajtës.

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR VENDOSJEN E KONDICIONERËVE NË OBJEKTET EKZISTUES***Kondicionimi:***

- Është një aksesor, i cili është bën një transformim të papëlqyeshëm për fasadën.
- Vendosja e kondicionerëve në fasadë nuk është e lejuar, përveçse në rastet kur vendosen në ballkone apo llozha.
- Montimi dhe vendosja e kondicionerëve duhet të jetë e parashikuar në mënyrë të tillë që, mos të ketë ndikim në fasadën e ndërtimit.
- Në rastet e objekteve ekzistues, njësia e kondicionimit, nëse nuk ka mundësi të vendoset e fshehur, duhet të vendoset në aks të dritareve dhe të gjithë të jenë në një linjë për secilin kat.

KËRKESË

Drejtuar:

Njësisë Administrative Nr. _____

BASHKISË SË ELBASANIT

Unë i/e nënshkruari/ja _____, kërkoj të kryejë disa punime, bazuar në Nenin 6, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar, në pronën time, me adresë si më poshtë:

Lagja _____, Rruga _____
 _____, Pallati _____, Shkalla_____, Ap._____, Telefon_____

Punimet që do të kryejë janë:

- 1. Ndërhyrje të jashtme** për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si më poshtë vijon:
 - rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjtë me ato ekzistuese;
 - pastrimi i fasadave;
 - riparimi dhe zëvendësimi i dritareve pa ndryshuar karakteristikat e tillë si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;
 - riparimi dhe zëvendësimi i dyerive, pa ndryshuar karakteristikat e tillë si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;
 - riparimi dhe zëvendësimi i qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tillë si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;
 - zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;
 - riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhaqeve, edhe me materiale të ndryshme;
 - riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
 - vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
 - vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
 - sistemimi i oborreve;
 - riparimi i rrethimeve ekzistuese.

2. Ndërhyrje të brendshme:

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;
- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;
- riparimi dhe rinovimi i dyerve;
- riparimi dhe rinovimi i dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave.

3. Ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare:

- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;
- a) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
 - b) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtoreale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.

Bashkëlidhur kësaj kërkese, janë bashkëlidhur:

1. Dokumenti i pronësisë (*fotokopje*)
2. Fotokopje e Kartës së Identitetit (për të gjithë bashkëpronarët)
3. Fotografi të gjendjes ekzistuese të objektit
4. Vërtetim të shlyerjes së pagesave të taksave vendore të objektit

DEKLARATË

Mbaj përgjegjësi për çdo lloj tejkalimi të punimeve që përfshin neni 6, "Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi", apo dëmi që i shkaktohet palëve të treta.

Deklaroj që lloji i punimeve është konform normave të përcaktuara në VKM nr. 408, "Pëmiratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar.

Sqaroj se, duhet të lajmëroj Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, përpëra se të vazhdoj me punimet e sipërpërmendura.

Marr përgjegjësi: Mbetjet ndërtimore duhet t'i depozitoj në vend-depozitimin e përkohshëm të mbetjeve të ngurta inerte që ka caktuar Bashkia Elbasan, me Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr. 66, datë 23.05.2019, në jug të fshatit Vidhas, Njësia Administrative Papër, në truall shtet me pasuri nr. 52/26 me kapacitet maksimal 1,000,000 ton nën juridiksonin e Bashkisë Elbasan.

Në rast të kundërt, nëse konstatohen mbetje inerte pranë mbetjeve shtëpiake, përgjatë ditëve kur kryej punime, marr përgjegjësi të plotë se ndaj meje do të ketë sanksione administrative.

Nënshkrimi i bashkëpronarëve

_____ (Emër, Mbiemër, firmë)

_____ (Emër, Mbiemër, firmë)